



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA

Planimet-Pranimet Nr. 037-03-2026			
Nr. Komunitetit	Nomenklatura	Udhëzuesi	Shënim
01-110/05-			382



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për Dhënien e Pronës së Palujtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.03.2026 miraton këtë:

## V E N D I M

### për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

#### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurt, deri 15 vite (pesëmbëdhjetë vite), për Njësinë Kadastrale me Nr.P-70101005-00630-0, në zonën kadastrale në Terpezë, pjesa prej 300 m<sup>2</sup>. Sipas çartifikatës së pronës, evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë.

Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

1. Fatmir Salihu, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
2. Fitim Selmani, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
3. Faruk Shabani, përfaqësues i kuvendit të komunës.
4. Labinot Bislimi, përfaqësues i kuvendit të komunës.
5. Shyqeri Halabaku, përfaqësues i sektorit joqeveritar.

#### Neni 2

Detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019), dhe Rregullorës Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

#### Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit, kurdoherë që kërkohet.

#### Neni 4

Obligohet Zyra për Prokurim që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të pronës së palujtshme të komunës, t'i zhvilloj proceurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, anëtarët e komisionit dhe Zyra për Prokurim e Komunës së Vitisë.

#### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024) dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarëve të komisionit;

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi